VENDIM
Nr.165, datë 31.5.2011

PËR DHËNIE LICENCE SHOQËRISË "CABLE ALBANIA DURRËS" SHPK, PËR TELEVIZIONIN PRIVAT KABLLOR "CABLE ALBANIA DURRËS"

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores së KKRT-së "Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kabllo", miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar me vendimet nr.503, datë 17.7.2006 dhe nr.883, datë 13.10.2009 të KKRT-së, rregullores së KKRT-së "Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, pasi mori në shqyrtim kërkesën e shoqërisë "Cable Albania Durrës" sh.p.k., për t'u licencuar si operator televiziv privat kabllor,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Cable Albania Durrës" sh.p.k., duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për "Cable Albania Durrës", për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence për të mbuluar me sinjal qytetin Durrës.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati